



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:225671

Datë: 10.02.2025

Numri i dokumentit: 06935451

KA.nr.992/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit së paditësit Shoqëria “Super-Viva” SH.P.K., me NUI 810800385, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Organi i Shkalles se Dyte i Inspektoratit te Punës, Ministria e Punës & Mirëqenies Sociale, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga avokatura shtetërore për shkak të anulimit të Vendimit Nr.01/06-196-2/2020 i datës 27.05.2021 dhe Vendimit INr.Prot.1037/2021 i datës 05.08.2021, jashtë seance me datë 10.02.2025, konform nenit 35 të LKA-së, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Shoqëria “Super-Viva” SH.P.K me seli në Prishtinë kundër të paditurit Organi i Shkalles se Dyte i Inspektoratit te Punës, Ministria e Punës & Mirëqenies Sociale, dhe anulohet si i kundërligjshëm Vendimit IP.Nr.Prot.1037/2021 i datës 05.08.2021 i Komisionit të shkallës së dytë i Inspektoratit të Punës dhe vendimi Nr.01/06-196-2/2020 i datës 27.05.2021 i organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës.
- II. Ky aktgjykim i zëvendëson aktin administrativ të anuluar me pikën I. të këtij dispozitivi.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

1. Më datë 08.10.2021, në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, paditësi Shoqëria “Super-Viva” SH.P.K., me NUI 810800385, me seli në Prishtinë, ka parashtruar padi kundër të paditurës Organi i Shkallës së Dytë i Inspektoratit të Punës, Ministria e Punës & Mirëqenies Sociale, me seli në Prishtinë, me kërkesëpadi për anulim të Vendimit INr.Prot.1037/2021 i datës 05.08.2021 i komisionit të shkallës së dytë i Inspektoratit të Punës dhe vendimi Nr.01/06-196-2/2020 i datës 27.05.2021 i organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 992/22.
3. Ka theksuar se vendimet e goditura me padi janë akte administrative të nxjerra në kundërshtim të drejtpërdrejte me nenin 70 par. 1 nën par. 1.1 të Ligjit të Punës, kjo për faktin se ish punëtore B.B i është shkëputur Kontrata e Punës duk iu ndërprerë që marrëdhënia e punës konform nenit 70 par. 1 në par. 1.1 të LPP-së, pasi që konform par.1 pika 1.3 i nenit 70 të Ligjit të Punës paditësi nuk ka pasur mundësi që ish punëtoren ta transferoj në një vend tjetër të punës, ta trajnojë dhe/apo kualifikoj për kryerjen e punëve dhe detyrave tjera tek i njëjti punëdhënës konform sanksioneve që dalin nga neni 17 dhe neni 18 i Ligjit të Punës. Me vendimet e goditura si organi i shkallës së parë ashtu dhe organi i shkallës së dytë të palës së paditur, ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitave relevante të Ligjit të Punës, që manifestohet me faktin se e paditura gjatë procedurës nuk i ka zbatuar drejtë dispozitat e këtyre ligjeve.
4. E paditura në përgjigje në padi të dorëzuar përmes parashtrësës së datës 02.12.2024 ka deklaruar se, organi i shkallës së dytë pran Inspektoratit të Punës, pasi ka shqyrtuar ankesën e paditësit ka gjetur se me vendimin e atakuar me ankesë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë duke i bërë të pa bazuara pretendimet ankimore të paditësit. Inspektorati i punës si i paditur i ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore, i ka vlerësuar drejtë et gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në nxjerrjen e vendimit, rrethana të cilat i ka aprovuar edhe organi i shkallës së dytë i Inspektoratit të Punës.

5. Gjykata pas shqyrtimit paraprak të paditës, shqyrtoj ligjshmërinë e vendimeve të kundërshtuara në pajtim me nenin 35 të LKA-së, ku përcaktohet *nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në përgjigje, dhe konstatoj që kërkesëpapia është e bazuar.*
6. Gjykata, shqyrtoi pranueshmërinë e padisë dhe vlerësoi atë në kuptim të nenit 6 par. 3 të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë i cili përcakton: *“Kundër vendimit të Inspektoratit të punës mund të ngritet kontesti administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh.”*, dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik në çështjet administrative.”*
7. Gjykata konstatoi se Vendimi nr. 01/06-196-2/2020 i datës 27.05.2021 i organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës, është nxjerrë në bazë të dispozitave të nenit 82 dhe 94 të Ligjit të Punës, nenit 1,2 dhe 5 të Ligjit për Inspektoratin e Punës, Ligjit Nr.03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 2002/9. Sipas dispozitivit të vendimit Inspektori i Punës pas shqyrtimit të ankesës së palës ankuese B.B, konstaton se Shoqëria “Super-Viva” SH.P.K., ka shkelur dispozitat e nenit 70 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës ku specifikohet se: *Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nën-paragrafit 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuari ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuari duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejme me shkrim, e sanksionuar me dispozitën e nenit 92 të të njëjtit ligj i cili specifikon se : 1. Personi fizik ose personi juridik që nuk i përfill dispozitat e këtij ligji , në procedurë ligjore , do të dënohej me të holla prej njëqind (100) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro dhe te Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2012 për Përcaktimin e Gjobave dhe shumave konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të Punës, koncretisht nenit 7 që parasheh Përcaktimin e gjobave*

dhe shumave konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të Punës, par. 3 parasheh se: prej 100 deri në 8.000 €, për çdo shkelje të dispozitës se: pika 3.15 Neni 70, ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit; dhe nenit 71 par. 2 *“Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t’i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë”*, e sanksionuar me dispozitën e nenit 92 të të njëjtit ligj i cili specifikon se : 1. Personi fizik ose personi juridik që nuk i përfill dispozitat e këtij ligji , në procedurë ligjore , do të dënohet me të holla prej njëqind (100) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro dhe te Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2012 për Përcaktimin e Gjobave dhe shumave konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të Punës, konkretisht nenit 7 që parasheh Përcaktimin e gjobave dhe shumave konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të Punës, par. 2 Prej 100 deri në 7.000 €, për çdo shkelje të dispozitës se: 2.30. Neni 71, koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës, dhe e njoftimit për mos vazhdimin e kontratës së punës në kohë të caktuar.

8. Me Vendimin IP.Nr.Prot.1037/2021 i datës 05.08.2021 të Komisionit të Organit të Shkallës së Dytë të Inspektoratit të Punës nga Ministria e Financave, Punës dhe Tranfereve, refuzohet si e pabazuar ankesa e Shoqëria “Super-Viva” SH.P.K., dhe vërtetohet Vendimi nr. 01/06-196-2/2020 i datës 27.05.2021 i organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës.
9. Gjykata vlerësoj se vendimet e kundërshtuara janë marrë në tejkalim të kompetencës ligjore dhe në kundërshtim me kompetencën e Inspektoratit të Punës, si dhe në kundërshtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në rastin nr. K027/21, të datës 16 dhjetor 2022 Nr. ref.:AGJ 2098/22 për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 94 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës lidhur me juridiksionin e Inspektoratit të Punës.
10. Lidhur me vlerësimin e kompetencës së të paditurit Gjykata iu referua Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjit Nr. 03/L-017, Neni 2, ku përcaktohen funksionet e Inspektoratit të punës, që: a) *Do të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë* b) *Do t’iu siguroj*

informacion teknik dhe këshilla punëdhënësve dhe punëtorëve për çështjet më të efektshme të zbatimit të dispozitave ligjore. c) Do të njoftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo ndonjë organ tjetër kompetent për ndonjë mungesë apo ndonjë shpërdorim në ligjin e aplikueshëm.) Do t'iu siguroj informatat dhe këshillat punëdhënësve dhe punëmarrësve të cilat do të jenë në pajtim me ligjin dhe ti paralajmërojnë autoritetet kompetente për çfarëdo defektesh apo shpërdorimesh që nuk janë përfshirë me dispozita ligjore ekzistuese. e) Do t'iu jep këshilla për çështje lidhur me ligjin e punës dhe mbrojtjen e punëtorëve me rastin e riorganizimit apo ristrukturimit të një ndërmarrjeje, dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin e punës nr. 2002/9, i cili në nenin 3 përcaktuar: “Teksti të pika „a” e nenit 2, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, zëvendësohet me tekstin „Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë.”

11. Gjykata vlerëson se tejkalimi i kompetencës ligjore nga Inspektorati i Punës, rezulton në faktin se sipas Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin e punës nr. 2002/9 në asnjë dispozitë ligjore nuk parashihet kompetenca e Inspektoratit të Punës për vendosje lidhur me të drejtat e të punësuarve nga marrëdhënia e punës. Por, sipas nenit 79 të Ligjit të Punës i cili përcakton se: “Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.” Prandaj, në rast se të punësuarit i janë shkelur të drejtat e tij me ndonjë vendim të punëdhënësit, i punësuarit mund që ti drejtohet gjykatës kompetente për shqyrtimin e pretendimeve të tij.
12. Gjykata Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në rastin nr. K027/21, të datës 16 dhjetor 2022 Nr. ref.:AGJ 2098/22 ka vlerësuar kushtetutshmërisë e nenit 94 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës lidhur me juridiksionin e Inspektoratit të Punës, ku në paragrafin 102 konstaton se: [...] *nuk rezulton të jete shkak i papajtueshmërisë së nenit 94 të Ligjit të Punës me Kushtetutën, gjegjësisht me nenet 3, 24, 31, 49 dhe 54 të Kushtetutës, por rezultat i interpretimit dhe i interpretimit dhe zbatimit të gabuar të nenit 94 të Ligjit të Punës dhe i Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, nga ana e Inspektoratit të Punës, dhe sipas paragrafit 104. ku*

konstaton se *Ligji i Punës, Ligji për Inspektoratin e Punës, Ligji për Siguri dhe Mbrojtje ne pune, mandatojne Inspektoratin e Punës për mbikëqyrjen e zbatimit te këtyre ligjeve ne pajtim me fushëveprimin dhe funksionet e përcaktuara ne nenin 1 dhe 2 te Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës. Por, as ne dispozitat e këtij ligji, ligjeve te tjera dhe as nga gjuha e nenit 94 te Ligjit te Punës, nuk mund te kuptohet e as te nënkuptohet qe një organ inspektues mund te përvetësoje funksione gjyqësore. Gjuha e normës kushtetuese është e qarte. Funksione gjyqësore mund te ushtrojnë vetëm gjykatat, sipas parimeve te përcaktuara me Kushtetute dhe ligjet përkatëse.*

13. Bazuar në këtë, gjykata vlerëson se i padituri Inspektorati i Punës ka tejkaluar kufijtë e kompetencës të cilat me ligj të veçantë janë përcaktuar tek një institucion tjetër, në këtë rast, të gjykatës, dhe me nxjerrjen e vendimit të kontestuar, ka vepruar në kundërshtim me nenin 5 par. 5 të Ligjit të Inspektoratit të Punës, par. 6 dhe 7 të Rregullores UA nr.07/2012 dhe nenin 70 par. 1.4 dhe 1.6 të Ligjit të Punës, andaj gjykata bazuar në nenin 35 të LKA-së, konstatoj se akti administrativ i lëshuar nga organi administrativ në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të përcaktuar ne LPPA, neni 4, *Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.* Sipas Nenit 52 paragrafi 1.1 dhe 1.2 të LPPA-së, 1. *Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; prandaj gjykata vlerësoj se mungesa e kompetencës përbën të meta esenciale, prandaj mbajtja e seancës për administrimin e provave nuk është e nevojshme sepse dëgjimi i palëve dhe provat tjera janë pa efekt në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të konstatuar.*
14. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi u morë në bazë të nenit 46 par. 3 dhe 4 të LKA-së. Ndërsa, vendimi për shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, u more në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.992/22, datë 10.02.2025

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.